



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 63

**Tiranë – E martë, 26 prill 2022**

## PËRMBAJTJA

|                                                             | Faqe                                                                                                                                                                                                 |
|-------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 30/2022, datë 14.4.2022            | Për disa ndryshime në vendimin nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”..... 8369                                                                          |
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 31/2022, datë 14.4.2022            | Për zgjedhjen e një komisioneri të Avokatit të Popullit..... 8369                                                                                                                                    |
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 32/2022, datë 14.4.2022            | Për zgjedhjen e një komisioneri të Avokatit të Popullit..... 8369                                                                                                                                    |
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 33/2022, datë 14.4.2022            | Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)... 8370 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 34/2022, datë 14.4.2022            | Për ngritjen e Nënkomisionit për Zhvillim të Qëndrueshëm, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financat..... 8372                                                   |
| Rezolutë e Kuvendit<br>datë 14.4.2022                       | Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit, për vitin 2021..... 8372                                                                                                                 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 234, datë 20.4.2022 | Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike..... 8374                                                      |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 235, datë 20.4.2022 | Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2022..... 8389                                         |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 236, datë 20.4.2022 | Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të kandidatëve për anëtar të Komisionit të Prokurimit Publik..... 8391                                                                           |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 237, datë 20.4.2022 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 737, datë 13.12.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH)”..... 8391            |

|                                                                                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |      |
|-------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 238, datë 20.4.2022                         | Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objektit të Institutit të Policisë Shkencore dhe caktimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si njësi zbatuese.....                                                                                                                                                 | 8392 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 239, datë 20.4.2022                         | Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rforcimit të njërive individuale të banimit dhe njërive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kavajë.....                                                                                                                                                                                   | 8392 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 240, datë 20.4.2022                         | Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare “Bago”, Bashkia Kavajë, dhe caktimin e Bashkisë Kavajë si njësi zbatuese.....                                                                                                                                                                                | 8393 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 241, datë 20.4.2022                         | Për përcaktimin e procedurave që ndiqen për prokurimet e bëra në një vend të tretë, përfshirë prokurimet civile të kryera kur Forcat e Armatosura të Republikës Së Shqipërisë janë dislokuar jashtë territorit të vendit dhe kur, për nevoja operacionale, duhet të lidhen kontrata me operatorët ekonomikë, që janë në vendin ku po kryhet operacioni..... | 8394 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 242, datë 20.4.2022                         | Për një shtesë në vendimin nr. 561, datë 29.7.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të ndryshuar.....                                                                                                                                               | 8395 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 244, datë 20.4.2022                         | Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtim kopshti dhe çerdhe e integruar nr. 42”.....                                                                                                                                                                                     | 8396 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 245, datë 20.4.2022                         | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 101, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2022”.....                                                                                    | 8398 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 246, datë 20.4.2022                         | Për miratimin e paketës së Programit Kombëtar për Kujdesin e Shikimit për Fëmijët .....                                                                                                                                                                                                                                                                     | 8399 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 248, datë 20.4.2022                         | Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2022, për pagesën e studios, për çështjen e anulimit të vendimit të arbitrazhit <i>Icsid Case no. Arb/14/26</i> .....                                                                                      | 8400 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe<br>Zhvillimit Rural<br>nr. 174, datë 15.4.2022  | Për përcaktimin e kriterëve për vaksinat që përdoren kundër sëmundjes së pseudopestit, në programet rutinë të vaksinimeve.....                                                                                                                                                                                                                              | 8400 |
| Njoftim i Ministrisë për Evropën<br>dhe Punët e Jashtme<br>nr. 5257, datë 20.4.2022 | Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | 8401 |

**VENDIM  
Nr. 30/2022****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN  
NR. 69/2021, “PËR CAKTIMIN  
E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË  
PËRHERSHME TË KUVENDIT”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës; të neneve 21, pika 2, dhe 55, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

Në vendimin e Kuvendit nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përherëshme të Kuvendit”, bëhen këto ndryshime:

I. Deputeti Pandeli Majko caktohet anëtar në Komisionin e Politikës së Jashtme dhe anëtar zëvendësues në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Deputeti Benet Beci nga anëtar zëvendësues caktohet anëtar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

III. Deputetja Etilda Gjonaj caktohet anëtare e Komisionit për Politikën e Jashtme në vend të deputetit Benet Beci.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE  
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 14.4.2022.

**VENDIM  
Nr. 31/2022****PËR ZGJEDHJEN E NJË KOMISIONERI  
TË AVOKATIT TË POPULLIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të neneve 33 e 33/1, të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Zonja Olta Aliaj zgjidhet Komisionere e Avokatit të Popullit në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE  
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 14.4.2022.

**VENDIM  
Nr. 32/2022****PËR ZGJEDHJEN E NJË KOMISIONERI  
TË AVOKATIT TË POPULLIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të neneve 33 e 33/1, të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Zoti Ahmet Prençi zgjidhet Komisioner i Avokatit të Popullit në Seksionin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE  
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 14.4.2022.



**VENDIM**  
**Nr. 33/2022**

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS,  
ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT  
TË POZICIONEVE TË PUNËS SË  
ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT  
TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)**

**VENDOSI:**

I. Struktura e ERRU-së është sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur.

II. Organika e ERRU-së është sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur.

III. Numri i punonjësve është 29.

IV. Vendimi nr. 34/2016, datë 28.4.2016, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)” shfuqizohet.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**KRYETARE**  
**Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 14.4.2022.

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe të nenit 9, pika 1, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU),

**STRUKTURA ORGANIZATIVE E ERRU**

*Lidhja nr.1*





ORGANIKA E DETAJUAR E ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË  
DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

LIDHJA NR. 2

| <b>KOMISIONI I ERRU-së</b>                                    | <b>Kategoria e pagës</b> | <b>Numri</b> |
|---------------------------------------------------------------|--------------------------|--------------|
| KRYETARI                                                      |                          | 1            |
| ANËTARË KOMISIONI                                             |                          | 4            |
| Sekretarja e Komisionit dhe kryetarit                         |                          | 1            |
| SEKRETAR I PËRGJITHSHËM                                       | I-b                      | <u>1</u>     |
| <br>DREJTORIA TEKNIKO-EKONOMIKE                               |                          | <u>9</u>     |
| Drejtor drejtorie                                             | II-b                     | 1            |
| <i>Sektori Teknik dhe i Licencave</i>                         |                          |              |
| Përgjegjës sektori                                            | III-a                    | 1            |
| Specialist i Rrjeteve Inxhinierike të Ujësjetësve dhe ITUP    | III-b                    | 1            |
| Specialist i Rrjeteve Inxhinierike të KUN dhe ITUN            | III-b                    | 1            |
| <i>Sektori Ekonomik dhe Tarifave</i>                          |                          |              |
| Përgjegjës sektori                                            | III-a                    | 1            |
| Specialist i Analizës Ekonomiko-financiare                    | III-b                    | 1            |
| Specialist i Analizës së Aseteve dhe Investimeve              | III-b                    | 1            |
| <i>Sektori i Monitorimit dhe Performancës</i>                 |                          |              |
| Specialist i Performancës Operative dhe Cilësisë së Shërbimit | III-b                    | 1            |
| Specialist i Performancës Ekonomiko-financiare                | III-b                    | 1            |
| DREJTORIA JURIDIKE DHE E KONSUMATORIT                         |                          | <u>5</u>     |
| Drejtor drejtorie                                             | II-b                     | 1            |
| <i>Sektori Juridik</i>                                        |                          |              |
| Specialist ligjor                                             | III-b                    | 2            |
| <i>Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Konsumatorin</i>   |                          |              |
| Specialist i Trajtimit të Ankesave                            | III-b                    | 1            |
| Specialist i Marrëdhënieve me Publikun                        | III-b                    | 1            |
| DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE                            |                          | <u>8</u>     |
| Drejtor drejtorie                                             | II-b                     | 1            |
| <i>Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Financiare</i>            |                          |              |
| Specialist i Burimeve Njerëzore                               | III-b                    | 1            |
| Specialist Finance                                            | III-b                    | 1            |
| <i>Sektori i Shërbimeve</i>                                   |                          |              |
| Specialist IT                                                 | III-b                    | 1            |
| Specialist Protokoll-arkiv                                    | IV-b                     | 1            |
| <i>Punonjës mbështetës</i>                                    |                          |              |
| Shoferë                                                       |                          | 2            |
| Magaznier dhe sanitarë                                        |                          | 1            |
| <b>TOTALI</b>                                                 |                          | <b>29</b>    |



**VENDIM**  
**Nr. 34/2022**

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT  
PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM,  
NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË  
PËRHERSHËM PARLAMENTAR  
PËR EKONOMINË DHE FINANCAT**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Ngrihet Nënkomisioni për Zhvillim të Qëndrueshëm në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financat.

II. Fusha e përgjegjësisë së këtij Nënkomisioni është zhvillimi ekonomik dhe social, rritja ekonomike e qëndrueshme, realizimi i objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe Agjenda 2030 e OKB-së.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 7 anëtarë si më poshtë:

|                   |                  |       |
|-------------------|------------------|-------|
| Anila Denaj       | kryetare         | (PS); |
| Sorina Koti       | zëvendëskryetare | (PD); |
| Enslemvera Zake   | anëtare          | (PS); |
| Pranvera Resulaj  | anëtare          | (PS); |
| Blerina Gjylameti | anëtare          | (PS); |
| Emilja Koliqi     | anëtare          | (PD); |
| Arbër Agalliu     | anëtar           | (PD). |

Anëtarë zëvendësues:

|                |       |
|----------------|-------|
| Antoneta Dhima | (PS); |
| Etjen Xhafaj   | (PS); |
| Fatjon Veizaj  | (PD). |

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 14.4.2022.

**REZOLUTË**

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË  
ENTIT RREGULLATOR TË UJIT,  
PËR VITIN 2021**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke njohur Entin Rregullator të Ujit si një institucion të pavarur publik, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar;

Duke theksuar se treguesit kryesorë të performancës, për vitin 2021, në sektorin UK paraqiten me një përmirësim të lehtë, me përjashtim të treguesve Mbulimi i Kostove O&M dhe Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë, të cilët mbesin në të njëjtën nivel me ato të vitit 2020;

Duke mbajtur parasysh se ky përmirësim i treguesve vjen pas përkeqësimit që patën gjatë pandemisë COVID-19 dhe tërmetit të fundvitit 2019;

Duke theksuar se ndryshimet ligjore të nevojshme, me gjithë periudhën disavjeçare që diskutohen, ende nuk janë realizuar, si dhe duke nxitur qeverinë dhe të gjithë aktorët për të propozuar sa më parë ndryshimet ligjore, të cilat pritet të kenë një ndikim pozitiv si në sektorin e UK-së, ashtu edhe në lidhje me pavarësinë institucionale dhe operacionale të ERRU-së, rolin të saj për mbrojtjen e konsumatorit, përcaktimin e saktë të kompetencave dhe shmangien e mbivendosjes së kompetencave, rritjen e efektivitetit etj.;

Duke theksuar nevojën e përmirësimit të aspekteve të menaxhimit nga shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve për t'i bërë ato më të qëndrueshme financiarisht, si dhe për të rritur transparencën e tyre me konsumatorët,

**Vlerëson për vitin 2021:**

- Përmirësimin e lehtë pothuajse të të gjithë treguesve kryesorë të performancës për vitin 2021 me përjashtim të treguesve Mbulimi i Kostove O&M dhe Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë, të cilët mbeten në të njëjtën nivel me një vit më parë.

- Krijimin e një praktike standarde monitorimi për shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, me qëllimin kryesor mbrojtjen e konsumatorit duke hartuar një program vjetor për monitorimin e këtyre shoqërive, për trajtimin e ankesave të konsumatorit, ku



tashmë për të nxitur shoqëritë për përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe mbrojtjen e konsumatorit, përgjigjet ndaj “Ankesave të klientëve” dhe “Zgjidhjet e ankesave të klientëve” do të ndikojnë në përditësimin tarifor përmes dhënies së bonusit/penalitetit.

- Miratimin e rregullores për procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes (ZAM) midis konsumatorit dhe operatorit ujësjellës-kanalizime nga struktura e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes, si një mundësi më shumë, e cila do të ndikojë në përmirësimin e procedurave dhe efikasitetin e zgjidhjes së problematikave dhe ankesave të konsumatorëve.

- Punën e bërë nga ERRU-ja për zgjidhjen e problematikës së mbifaturimit të konsumatorëve familjarë kur ata nuk janë të pajisur me matës dhe faturohen aforfe mbi normën e konsumit prej 150 litrash/ditë/person ( $4.5 \text{ m}^3/\text{muaj/person}$ ).

- Përpjekjet për të bërë të mundur promovimin e institucionit përmes dëgjësive publike, si dhe nëpërmjet rrjeteve sociale, të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre, si dhe në rritjen e besimit të konsumatorëve tek ERRU-ja për mbrojtjen e interesave të tyre.

- Rishikimin e metodologjisë tarifore përmes miratimit të dokumentit “Metodologjia dhe procedura për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve”. Metodologjia e rishikuar përmban dy metoda të llogaritjes së tarifave, atë ekzistuese të rishikuar “Kosto-plus”, e cila do të vazhdojë të përdoret për shoqëritë UK që propozojnë rritje tarifash deri në mbulimin 100% të kostove të O&M dhe ajo e “Çmimit tavan”, e cila kërkon që shoqëritë të aplikojnë për tarifa të reja detyruesisht bazuar në një plan biznesi 5-vjeçar dhe aplikohet për tarifa të propozuara për shoqëritë me target mbulimin deri në 100% të kostove kapitale të aktivitetit.

- Studimin e bërë nga ERRU-ja për problematikën e mbulimit të kostove të energjisë për shoqëritë UK, si një problematikë e mbartur në vite dhe tepër e rëndësishme për t'u zgjidhur. Studimi ka për qëllim paraqitjen e gjendjes së shoqërive UK me nivel debie të lartë ndaj OSHEE-së, analizën e faktorëve që kanë ndikuar në akumulimin e kësaj debie, si dhe dhënien e rekomandimeve për mundësinë e shlyerjes së tyre.

### **Kuvendi i Shqipërisë, për vitin 2022, rekomandon:**

1. ERRU-ja, në bashkëpunim edhe me Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUM), si dhe me aktorët e tjerë në sektorin UK, duhet të bashkërendojë punën për të gjetur zgjidhje konkrete dhe mekanizmat e duhur për të vënë në pozita pune ndërmarrjet UK dhe përmirësimin e performancës në sektor, veçanërisht të ujit pa të ardhura. Grantet apo financimet që jepen për ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve duhet të kushtëzohen me arritjen e objektivave të vënë nga ERRU-ja dhe rritjen e performancës. Është e papranueshme që edhe pse nga njëra anë investimet e qeverisë në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve rriten dhe nga ana tjetër humbjet (uji pa të ardhura) për vite me radhë vijojnë të mbeten në nivele tepër të larta, ka keqmenaxhim të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve.

2. ERRU-ja të japë kontributin e saj konkret në kuadër të nismës së qeverisë qendrore, të ndërmarrë gjatë vitit 2021 mbi agregimin e sektorit si avantazh i ekonomisë së shkallës për përmirësimin e performancës së sektorit në drejtim të përmirësimit të eficiencës operationale dhe qëndrueshmërisë financiare.

3. ERRU-ja të japë kontributin e saj konkret dhe të bashkëpunojë ngushtësisht me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, AKUM-in (Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve), AMBU-në (Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore), pushtetin vendor, si dhe me aktorët e tjerë kryesorë të sektorit të ujit në mbështetje të strategjisë së reformës për të bërë të mundur përmirësimin rrënjësor të performancës së sektorit ujësjellës-kanalizime.

4. ERRU-ja, në monitorimet e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve në terren, të kontrollojë me rigorozitet profilin e punonjësve të tyre në mënyrë që të përputhet me pozicionin e tyre të punës.

5. ERRU-ja të rekomandojë rishikimin e legjislacionit për mundësi të tjera alternative teknike për garantimin e sigurisë së ujësjellësve (monitorimin në distancë të objekteve me kamera), për të bërë të mundur rritjen e eficiencës së stafit dhe uljen e numrit të punonjësve. Shërbimi me personel roje fizike i sigurisë së objekteve të ujësjellësve ka ndikim negativ në treguesin e eficiencës së stafit, (treguesi i eficiencës së stafit pa



përfshirë shërbimin rojë do të ishte në nivelin e 4.9 punonjës për 1000 lidhje nga 5.28 punonjës për 1000 lidhje, për shkak të punonjësve të sigurisë për ruajtjen e objekteve të ujësjellësve).

6. ERRU-ja të vijoje punën për procesin e monitorimit të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve për mënyrën e trajtimit të ankesave të konsumatorëve dhe evidentimit të problematikave që kanë shoqëritë në drejtim të ofrimit të shërbimit ujësjellës-kanalizime, duke lënë rekomandime konkrete për t'u realizuar nga ato.

7. ERRU-ja të luajë një rol proaktiv dhe të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për rishikimin e ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, për forcimin e rolit të rregullatorit si institucion i pavarur në funksion të rritjes së performancës së sektorit në përgjithësi, si dhe për riaktivizimin e grupit të punës për të bërë të mundur ndryshimet e nevojshme ligjore për eliminimin e problemeve të licencimit të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve për plotësimin e kushteve të aktmiratimit të lejes higjieno-sanitare

8. ERRU-ja, në ristrukturimin e faqes zyrtare në internet, të bëjë të mundur që faqja e re të jetë më pranë konsumatorit, më e lehtë në përdorim dhe ku konsumatorët të kenë akses për komente, ankesa dhe pjesëmarrje për problematikat e ndryshme të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve që ofrohen nga shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve.

9. ERRU-ja, në vijim të studimit të bërë nga ana e saj për problematikën e mbulimit të kostove të energjisë, për shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, të iniciojë një bashkëpunim AKUM–ERRU–OSHEE për të kryer një analizë të thelluar të gjendjes për shoqëritë problematike në drejtim të pagesës së faturës së energjisë elektrike, sipas një vlerësimi real të treguesve kryesorë të performancës (TKP), si dhe të firmoset një kontratë performace bazuar në objektiva që synojnë përmirësimin e gjendjes financiare të këtyre shoqërive.

**KRYETARE  
Lindita Nikolla**

Miratuar në datën 14.4.2022.

## VENDIM

**Nr. 234, datë 20.4.2022**

### **PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE PUNONJËSVE TË TJERË TË SPECIALITETEVE TË NDARYSHME NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen punonjësit mbështetës dhe punonjës të tjerë të specialiteteve të ndryshme (në vijim, punonjësit) në:

a) institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura, në nivel qendror, e në administratën e prefektit;

b) institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura, në nivel rajonal/vendor, e në institucionet qendrore të grupit të tretë të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes.

2. Struktura e pagës bruto mujore të punonjësve të përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, është si vijon:

a) paga bazë për klasë;

b) shtesa për vjetërsi në punë;

c) shtesa për funksion drejtues;

ç) shtesa për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin;

d) shtesa për natyrë të veçantë pune, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

3. Punonjësit e institucioneve të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, trajtohen me sistemin e pagës bazë për klasë me 9 klasa, sipas lidhjes I, “Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën ‘a’, të pikës 1, të këtij vendimi”.

4. Punonjësit e institucioneve të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, trajtohen me sistemin e pagës bazë për klasë me 13 klasa, sipas lidhjes II, “Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të



përmendura në shkronjën ‘b’, të pikës 1, të këtij vendimi”.

5. Renditja e pozicioneve të punës për punonjësit e institucioneve të përmendura në shkronjën ‘a’, të pikës 1, të këtij vendimi, është sipas krerëve I/1 deri në I/11, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

6. Renditja e pozicioneve të punës për punonjësit e institucioneve të përmendura në shkronjën ‘b’, të pikës 1, të këtij vendimi, është sipas krerëve II/1 deri në II/3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

7. Shtesa për vjetërsi në punë llogaritet për çdo vit pune, në masën 1 (një) për qind të pagës bazë për klasë, por jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) për qind. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi. Përfshihen nga kjo llogaritje vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

8. Punonjësit, kur punojnë në funksione drejtuese, përfitojnë shtesë mbi pagën bazë për klasë në përqindje, sipas shkallëzimit në 5 (pesë) grupe, si më poshtë vijon:

- a) grupi i parë 5%;
- b) grupi i dytë 10%;
- c) grupi i tretë 15%;
- ç) grupi i katërt 20%;
- d) grupi i pestë 30%.

9. Për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, punonjësve u jepet shtesë mbi pagë, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë, si më poshtë vijon:

- a) në shkallën e parë, në masën 1 335 (një mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë në muaj;
- b) në shkallën e dytë, në masën 4 005 (katër mijë e pesë) lekë në muaj;
- c) në shkallën e tretë, në masën 5 340 (pesë mijë e treqind e dyzet) lekë në muaj;
- ç) në shkallën e katërt, në masën 6 675 (gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në muaj.

Ndarja e punëve sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë bëhet sipas lidhjes III, “Kriteret e

ndarjes së punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10. Zbatimi i shtesës së përcaktuar në pikën 9, të këtij vendimi, sipas shkallëve përkatëse të vështirësisë e të dëmshmërisë bëhet, si më poshtë vijon:

a) drejtoritë/njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucioneve të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, u paraqesin kërkesën e tyre drejtorive të shëndetit publik, të cilat përcaktojnë vendet e punës, të vështira e të dëmshme për shëndetin e punëmarrësve, si dhe shkallën e vështirësisë e dëmshmërisë, për çdo vend pune;

b) pas përcaktimit të shkallës së vështirësisë e dëmshmërisë, sipas shkronjës ‘a’, të kësaj pike, titullarët e institucioneve paraqesin kërkesën për miratim në ministrinë përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë dhe në ministrinë përgjegjëse për çështjet e punësimit;

c) pas marrjes së miratimit nga dy ministrinë të përmendura në shkronjën ‘b’, të kësaj pike, titullarët miratojnë dhënien e këtyre shtesave për punonjësit e institucioneve të sistemit të tyre. Për institucionet qendrore, në varësi të ministrave të linjës, si dhe ato rajonale e vendore, ky miratim bëhet nga ministri përkatës, në varësi të të cilit janë këto institucione;

ç) kur punonjësit i takon të marrë dy a më shumë shtesa sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë, ai do të marrë nga një shtesë vështirësie për çdo shkallë, por jo më shumë se 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj;

d) këto shtesa, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë së pozicioneve të punës, u rekomandohen edhe punëdhënësve të tjerë të administratës publike, pagat e të cilëve nuk përcaktohen sipas këtij vendimi apo edhe subjekteve private.

11. Paga dhe shtesa mbi pagë për punonjësin që punon në pozicionin “shofer i titullarit” është, si më poshtë vijon:

a) në rastet kur titullarët e institucioneve të përmendura në shkronjën ‘a’, të pikës 1 të këtij vendimi, janë të klasifikuar në grupin ‘A’, për efekt të ligjit përkatës për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, dhe të cilët, në bazë të ligjit përkatës për rregullimin e shërbimit të transportit për



funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë, kanë në dispozicion shoferë që nuk janë punonjës të Gardës së Republikës, shoferi i titullarit përfiton pagën bazë mujore sipas klasës VI, të lidhjes I që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe një shtesë mujore për natyrë të veçantë pune, në masën 13 500 (trembëdhjetë mijë e pesëqind) lekë në muaj;

b) në rastet kur titullarët e institucioneve të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, janë të klasifikuar në grupet “B” dhe “C”, për efekt të ligjit përkatës për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, dhe të cilët, në bazë të ligjit përkatës për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë, kanë në dispozicion shoferë, shoferi i titullarit përfiton pagën sipas klasës V, të lidhjes I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe një shtesë mujore për natyrë të veçantë, në masën 9 500 (nëntë mijë e pesëqind) lekë në muaj;

c) shoferët e titullarëve të tjerë, të cilët, në bazë të ligjit përkatës për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë, kanë në dispozicion shoferë, përfitojnë pagën sipas klasës IV, të lidhjes I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe një shtesë mujore për natyrë të veçantë pune, në masën 6 500 (gjashtë mijë e pesëqind) lekë në muaj.

12. Për natyrë të veçantë pune jepet një shtesë mbi pagën bazë mujore të klasës përkatëse, e, konkretisht:

a) punonjësve të sektorit të teknikës e shtypshkrimit, në Qendrën e Botimeve Zyrtare, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj;

b) punonjësve shpëtues të sektorit të emergjencave dhe shpëtimit, të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj;

c) punonjësve të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj;

ç) punonjësve në pozicionin “shofer-mekanik” në Qendrën e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj;

d) punonjësve, të cilët punojnë në shërbimet e shëndetit mendor e që janë në kontakt të

drejtpërdrejtë me pacientët me probleme të shëndetit mendor, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj. Ministri përgjegjës për çështjet e shëndetësisë përcakton vendet e punës që përfitojnë këtë shtesë, me miratimin e strukturave të institucioneve shëndetësore përkatëse;

dh) punonjësve, të cilët punojnë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me të dënuarit, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj. Kjo shtesë aplikohet pas miratimit të strukturave të institucioneve të ekzekutimit të veprave penale përkatëse, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për çështjet e drejtësisë;

e) punonjësve në pozicionin “shofer” në urgjencën e spitaleve, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj;

ë) punonjësve në pozicionin “roje mjedisore” në administratat e zonave të mbrojtura, në masën 4 000 (katër mijë) lekë në muaj;

f) punonjësve në pozicionet “përgjegjës (shërbimi i ushqimit dhe restorantit)”, “kuzhinier”, “administrues hoteli” dhe “ndihmëskuzhinier” në Shtëpinë e Pushimit të Ministrisë së Brendshme, Durrës, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj.

13. Paga mujore për punonjësit që punojnë në pozicionin “prozektor” në Institutin e Mjekësisë Ligjore, është e njëjtë me pagën mujore për të njëjtin pozicion pune në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, e përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e personelit mjekësor dhe punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

14. Vendimi nr. 717, datë 23.6.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës në institucionet buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar, shfuqizohet.

15. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2022, përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 prill 2022.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama



## Lidhja I

Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi

| Nr. rendor | Klasa e pagës | Paga bazë mujore për klasë |
|------------|---------------|----------------------------|
| 1          | I             | 32000                      |
| 2          | II            | 32700                      |
| 3          | III           | 33400                      |
| 4          | IV            | 34100                      |
| 5          | V             | 35250                      |
| 6          | VI            | 36300                      |
| 7          | VII           | 38300                      |
| 8          | VIII          | 39800                      |
| 9          | IX            | 41000                      |

## Lidhja II

Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi

| Nr. rendor | Klasa e pagës | Paga bazë mujore për klasë |
|------------|---------------|----------------------------|
| 1          | I             | 32000                      |
| 2          | II            | 32700                      |
| 3          | III           | 33400                      |
| 4          | IV            | 34100                      |
| 5          | V             | 34500                      |
| 6          | VI            | 35000                      |
| 7          | VII           | 35400                      |
| 8          | VIII          | 36000                      |
| 9          | IX            | 36500                      |
| 10         | X             | 37000                      |



|    |      |       |
|----|------|-------|
| 11 | XI   | 37500 |
| 12 | XII  | 38200 |
| 13 | XIII | 39800 |

**Lidhja III****Kriteret e ndarjes së punëve sipas shkallës të vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin**

Në zbatim të pikës nr. 9 të këtij vendimi, punë që kryhen në kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, konsiderohen ato punë që kryhen në ambiente që kapërcejnë kufijtë e lejueshëm të faktorëve të dëmshëm për shëndetin, që përcaktohen në dispozita të veçanta ose në norma të detyrueshme higjieno-sanitare.

Ndarja e punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin është si vijon:

**1. Në shkallën e parë përfshihen punët që kryhen:**

|    |                                                                                                                                  |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| a  | Në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të pluhurave, që nuk shkaktojnë dëmtime të mushkërisë;                                     |
| b  | Në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të substancave toksike, që nuk depozitohen në organizëm;                                   |
| c  | Në ambientet e mbyllura, në të cilat për arsye teknologjike mbahet konstante temperatura mbi 25 gradë, ose nën 10 gradë celsius; |
| ç  | Në një ambient të lagësht me lagështi relative të ajrit mbi 80 për qind, në baltë ose në kontakt të drejtpërdrejtë me ujë;       |
| d  | Në kushtet e ekspozimit ndaj rrezatimit ultraviolett ose infra të kuqe, për shembull saldimit, farkëtimi etj.;                   |
| dh | Në kushtet e vibrimit të përgjithshëm;                                                                                           |
| e  | Në ambientet në të cilat është i domosdoshëm përdorimi i ndriçimit artificial.                                                   |

**2. Në shkallën e dytë përfshihen punët që kryhen:**

|    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| a  | Në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të pluhurave që shkaktojnë dëmtime të mushkërisë;                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| b  | Në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të substancave toksike që depërtojnë në organizëm;                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| c  | Në kushtet e ekspozimit ndaj zhurmave;                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| ç  | Në kushtet e presionit të ulur ose të ngritur për arsye të procesit teknologjik;                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| d  | Në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të vibrimit lokal, për shembull përdorimi i pajisjeve pneumatike me dorë;                                                                                                                                                                                                                                                                                |
6. Zv.drejtor i përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, kategoria II-b;

7. Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kategoria II-b;

8. Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kategoria II-b;

9. Drejtor i Drejtorisë së Integritetit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Infrastrukturë dhe Energji, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, kategoria II-b.

**II- Niveli i ulët drejtues dhe të barasvlershëm**

1. Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve të Përgjithshme, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Mbështetëse, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, kategoria III-a;

2. Përgjegjës i Sektorit të Inovacionit, në Drejtorinë e Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, kategoria III-a;

3. Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Monitorimit, në Agjencinë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, kategoria III-a;

4. Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve Multilaterale, në Drejtorinë e Programeve Ndërkombëtare, në Agjencinë Kombëtare të



Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, kategoria III-a/1;

5. Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Materialeve të Tepërta, në Drejtorinë e Miradministrimit të Pronave dhe Aseteve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Mbrojtjes, kategoria III-a;

6. Koordinator në Njësinë Ligjore të Koordinimit të Nismave Prioritare dhe të *Acquis*, në Departamentin Rregullator dhe të Përputhshmërisë, në Kryeministri, kategoria III-a;

7. Koordinator në Njësinë e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA, në Departamentin Rregullator dhe të Përputhshmërisë, në Kryeministri, kategoria III-a;

8. Koordinator në Drejtorinë e Menaxhimit të Sigurisë së Komunikimit, në Departamentin e Miradministrimit, në Kryeministri, kategoria III-a;

9. Koordinator në Drejtorinë e Menaxhimit të Sigurisë së Komunikimit, në Departamentin e Miradministrimit, në Kryeministri, kategoria III-a;

10. Koordinator në Drejtorinë e Menaxhimit të Sigurisë së Komunikimit, në Departamentin e Miradministrimit, në Kryeministri, kategoria III-a;

11. Përgjegjës i Sektorit të Monitorim-Kontrollit, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, kategoria III-a/1;

12. Përgjegjës i Sektorit të Përfaqësimit Gjyqësor, në Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe të Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Drejtësisë, kategoria III-a;

13. Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Projekteve IPA dhe Donatorëve në Fushën e Drejtësisë, në Drejtorinë e Projekteve në Fushën e Drejtësisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Projekteve në Fushën e Drejtësisë, Integritetit dhe Negociatave, në Ministrinë e Drejtësisë, kategoria III-a;

14. Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, kategoria III-a;

15. Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Zhvillimit të Shërbimit Spitalor, në Drejtorinë e Politikave të Shërbimit Spitalor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Shëndetësinë, në

Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kategoria III-a;

16. Përgjegjës i Sektorit të Projekteve dhe Inovacionit, në Drejtorinë e Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kategoria III-a;

17. Përgjegjës i Sektorit të Analizave dhe Statistikave, në Drejtorinë e Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kategoria III-a;

18. Përgjegjës i Sektorit të Programeve të Zhvillimit Urban, në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, kategoria III-a;

19. Përgjegjës i Sektorit të Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve në Fushën e Industrisë dhe Energjisë, në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Industrisë dhe Energjisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, kategoria III-a;

20. Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, në Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe të Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, kategoria III-a;

21. Drejtor në Drejtorinë e Vlerësimit të Impaktit dhe Licencimit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, kategoria III-a;

22. Përgjegjës në Sektorin e Ankimimeve (apelim, ekzekutim dhe trajtim i penaliteteve), në Drejtorinë e Inspektim-Kontrollit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, kategoria III-a/1;

23. Përgjegjës i Sektorit të Komunikimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kategoria III-a/1;

24. Drejtor Rajonal i Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, kategoria III-a;

25. Përgjegjës i Sektorit të Administratës dhe Shërbimit, Dega Doganore Kukës (Morinë), kategoria III-a/1;

26. Kryetar i Degës Doganore Tre Urat Përmet, kategoria III-a/1.



**VENDIM**  
**Nr. 236, datë 20.4.2022**

**PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË  
KANDIDATËVE PËR ANËTAR TË  
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 25, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të listës së kandidatëve të kualifikuar për anëtar të Komisionit të Prokurimit Publik, sipas renditjes në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Dërgimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë edhe të listës së kandidatëve, që nuk plotësojnë kriteret për emërim, sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**ANEKS NR. 1**

**LISTA E KANDIDATËVE TË  
KUALIFIKUAR, SIPAS RENDITJES  
ME PIKË  
KANDIDATË TË KUALIFIKUAR PËR  
ANËTAR TË KPP-së**

| <b>Nr.</b> | <b>Emër, Mbiemër</b>     | <b>Pikë</b> |
|------------|--------------------------|-------------|
| 1          | Nertila Mihali (Juriste) | 69          |
| 2          | Bledar Cengu (Jurist)    | 62          |
| 3          | Gjergji Mersini (Jurist) | 55          |

**ANEKS NR. 2**  
**LISTA E KANDIDATËVE TË  
SKUALIFIKUAR QË NUK PLOTËSOJNË  
KRITERET PËR TË EMËRUAR ANËTAR  
TË KPP-së**

1. Nevila Dalipi
2. Lindita Xhillari (Hanku)

**VENDIM**  
**Nr. 237, datë 20.4.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA  
NË VENDIMIN NR. 737, DATË 13.12.2017,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,  
“PËR NGRITJEN E QENDRËS SË  
KOORDINIMIT KUNDËR  
EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM  
(QKEDH)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në vendimin nr. 737, datë 13.12.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikat 1, 6, 7, shkronjat “b” e “g”, dhe 12, emërtimi “Kryeministri”, zëvendësohet me “ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”.

2. Në pikën 4, hiqen fjalët “... miratuar me vendimin nr. 930, datë 18.11.2015, të Këshillit të Ministrave.”.

3. Në pikën 5 bëhen këto ndryshime:

a) në shkronjën “ç” hiqen fjalët “... por jo vetëm ...”;

b) shkronja “d” ndryshohet, si më poshtë vijon:  
“d) Koordinon planin e veprimit kundër ekstremizmit të dhunshëm në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse;”.

c) shkronja “dh” ndryshohet, si më poshtë vijon:



“dh) Informon, sa herë që kërkohet nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, për çështje në zbatim të ushtrimit të kompetencave të saj.”.

4. Në pikën 7 bëhen këto ndryshime:

a) në shkronjën “dh” hiqen fjalët “... dhe porosi, me shkrim ose verbale, ...”;

b) në shkronjën “e”, pas fjalës “... të nevojshme, ...” shtohen fjalët “pas marrjes së miratimit të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ...”.

5. Në pikën 8, në fund të fjalisë, shtohen fjalët “... me propozimin e ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.”.

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

#### VENDIM

Nr. 238, datë 20.4.2022

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË  
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E  
RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT TË  
INSTITUTIT TË POLICISË  
SHKENCORE DHE KAKTIMIN  
E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME  
TË POLICISË SË SHETIT  
SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nëndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 117/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objektit të Institutit të Policisë Shkencore, në masën 653 582 498 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tre milionë e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

2. Në buxhetin e miratuar për vitin 2022, për Ministrinë e Brendshme, në programin buxhetor “Policia e Shtetit” 03440, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, shtohet fondi prej 130 716 500 (njëqind e tridhjetë milionë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekësh pa TVSH, për financimin e rindërtimit të objektit të Institutit të Policisë Shkencore.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit caktohet si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit të objektit të Institutit të Policisë Shkencore.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

#### VENDIM

Nr. 239, datë 20.4.2022

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË  
RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E  
RIFORCIMIT TË NJËSIVE  
INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE  
NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA  
(PALLAT), NË BASHKINË KAVAJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nëndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.



115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 1 135 011 697 (një miliard e njëqind e tridhjetë e pesë milionë e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, nga Bashkia Kavajë, për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, në masën 227 002 339 (dyqind e njëzet e shtatë milionë e dy mijë e treqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, i cili do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.

3. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

#### VENDIM

Nr. 240, datë 20.4.2022

#### **PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË SHKOLLËS 9- VJEÇARE “BAGO”, BASHKIA KAVAJË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAVAJË SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për

menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare “Bago”, Bashkia Kavajë, në masën 197 156 668 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Kavajë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 39 431 333 (tridhjetë e nëntë milionë e katërqind e tridhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare “Bago”, Bashkia Kavajë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit.

3. Bashkia Kavajë caktohet si njësi zbatuese për financimin e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare “Bago”, Bashkia Kavajë, sipas pikave 1 e 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 241, datë 20.4.2022**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE  
QË NDIQEN PËR PROKURIMET E  
BËRA NË NJË VEND TË TRETË,  
PËRFSHIRË PROKURIMET CIVILE TË  
KRYERA KUR FORCAT E ARMATOSURA  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË JANË  
DISLOKUAR JASHTË TERRITORIT TË  
VENDIT DHE KUR, PËR NEVOJA  
OPERACIONALE, DUHET TË LIDHEN  
KONTRATA ME OPERATORËT  
EKONOMIKË, QË JANË NË VENDIN  
KU PO KRYHET OPERACIONI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronja “ç”, dhe 2, të nenit 5, të ligjit nr. 36/2020, “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim ka si objekt përcaktimin e procedurave, që ndiqen për prokurimet e bëra në një vend të tretë, përfshirë prokurimet civile të kryera, kur Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë dislokuar jashtë territorit të vendit dhe kur, për nevoja operationale, duhet të lidhen kontrata me operatorët ekonomikë, që janë në vendin ku po kryhet operacioni.

2. Qëllimi i këtij vendimi është plotësimi i nevojave operationale të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në rastet e dislokimit jashtë vendit dhe kur është i pamundur krijimi i strukturave përgjegjëse të procesit të prokurimit e kryerja e procedurave standarde të blerjes së mallit/shërbimit/punëve.

3. Ky vendim zbatohet për blerjen e të gjitha shërbimeve/mallrave/punëve për plotësimin e nevojave operationale të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë të dislokuara jashtë territorit të vendit dhe që janë të paparashikuara në marrëveshjen teknike të nënshkruar ndërmjet shtetit pritës, shtetit udhëheqës të misionit dhe/ose shteteve pjesëmarrëse në të ose kur, për shkaqe

specifike të misionit, nuk zbatohet marrëveshja teknike.

4. Ky vendim nuk zbatohet për blerjen e armatimit, të municioneve dhe të pajisjeve të tjera speciale të ushtarakut.

5. Në zbatim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

5.1 “Marrëveshje teknike”, marrëveshja e nënshkruar ndërmjet shtetit pritës, shtetit udhëheqës të misionit ose stërvitjes ushtarake dhe/ose shteteve pjesëmarrëse në të, e cila dakordëson për të drejtat e detyrimit e palëve, përpara fillimit të misionit ose të stërvitjes ushtarake.

5.2 “Nevoja operationale”, situatat urgjente dhe jourgiente (që nuk ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në operationalitet), plotësimi i të cilave nuk cenon në kohë, burime dhe në kapacitete realizimin e misionit.

5.3 “Personi përgjegjës për kryerjen e blerjes”, drejtuesi i misionit ose i stërvitjes ushtarake/përfaqësuesi ushtarak, që është në mision ose stërvitje ushtarake jashtë vendit, sipas përcaktimeve të urdhrit të ministrit përgjegjës për mbrojtjen, për dërgimin e personelit në mision ose në stërvitje ushtarake.

5.4 “Struktura përgjegjëse eprorë”, struktura përgjegjëse, në varësi të së cilës është personeli, që dërgohet në mision apo në stërvitje ushtarake.

5.5 “Shkaqe specifike të misionit”, rastet kur ushtarakët ndodhen në mes të një konflikti të armatosur dhe paraqitet një nevojë urgjente për furnizim me mall/shërbim a punë, e cila nuk pret deri në kthimin në bazën ushtarake përkatëse.

**KREU II  
PROCEDURAT E BLERJEVE TË  
SHËRBIMEVE/MALLRAVE/PUNËVE**

1. Për realizimin e misionit ose të stërvitjes, për blerjen e shërbimeve/mallrave/punëve, drejtuesi i misionit ose i stërvitjes ushtarake/përfaqësuesi ushtarak, që është në mision ose stërvitje ushtarake jashtë vendit, për shkak të nevojës urgjente për furnizim, kryen blerjen e shërbimeve mallrave / punëve, duke përzgjedhur vetë operatorin/ët ekonomikë dhe negocion kushtet e kontratës me një ose më shumë prej tyre. Në këtë rast, drejtuesi i misionit ose i stërvitjes ushtarake/përfaqësuesi ushtarak që është në mision ose në stërvitje



ushtarake jashtë vendit negocion me ofertuesin/t, me qëllim përshtatjen e ofertave të tyre me kërkesat për realizimin e misionit ose stërvitjes.

1.1 Drejtuesi i misionit ose i stërvitjes ushtarake/përfaqësuesi ushtarak, që është në mision ose në stërvitje ushtarake jashtë vendit harton e ruan, në përputhje me legjislacionin tatimor të vendit ku kryhet operacioni, dokumentacionin vërtetues për kryerjen e blerjes, që është: kontrata (aty ku është e mundur), fatura elektronike (aty ku është e mundur)/fatura e shitjes, fletëhyrja e mandatpagesa dhe, në momentin e kthimit në atdhe, e paraqet atë pranë njësisë ushtarake përgjegjëse.

1.2 Për blerjen e këtyre shërbimeve / mallrave / punëve, drejtuesi i misionit ose i stërvitjes ushtarake / përfaqësuesi ushtarak njofton, nëpërmjet komunikimit elektronik, autoritetet e komandim-kontrollit, sipas hierarkisë.

1.3 Në çdo rast, aktivet merren në administrim nga komandanti i kontingjentit, drejtuesi/përfaqësuesi i misionit ose i stërvitjes.

2. Për blerjen e shërbimeve/mallrave/punëve, të cilat nuk ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në operacionalitetin për realizimin e misionit ose të stërvitjes dhe për të cilat kërkohet asistencë, drejtuesi i misionit ose i stërvitjes ushtarake/përfaqësuesi ushtarak, që është në mision ose stërvitje ushtarake jashtë vendit, paraqet, nëpërmjet komunikimit elektronik, kërkesën për blerje pranë strukturës përgjegjëse eprorë, sipas hierarkisë, e cila, jo më shumë se 5 (pesë) ditë pune nga e nesërmja e ditës së marrjes së saj, kthen përgjigje për miratimin apo refuzimin e kërkesës.

2.1 Pas miratimit të kërkesës për blerje nga struktura përgjegjëse eprorë, drejtuesi i misionit ose i stërvitjes ushtarake/përfaqësuesi ushtarak, që është në mision ose në stërvitje ushtarake jashtë vendit, do të ndjekë të njëjtën procedurë dhe do të hartojë të njëjtin dokumentacion, siç parashikohet në pikën 1, të këtij kreu.

3. Struktura përgjegjëse eprorë, si dhe strukturat e tjera zbatuese të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kontrollin dhe auditin financiar të veprimtarisë së organeve shtetërore kryejnë kontrole financiare për procedurat e blerjes, objekt i këtij vendimi, referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë saj nga drejtuesi i misionit ose i stërvitjes ushtarake/përfaqësuesi ushtarak, që është në mision ose në stërvitje ushtarake jashtë vendit.

### KREU III DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

### VENDIM Nr. 242, datë 20.4.2022

#### **PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 561, DATË 29.7.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR STANDARDIZIMIN DHE DISIPLINIMIN E SHPENZIMEVE TË KARBURANTIT NË NJËSITË E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

### VENDOSI:

Në pikën 1/1, të vendimin nr. 561, datë 29.7.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas togfjalëshit “... Policisë së Shtetit...” shtohen fjalët “... dhe të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 244, datë 20.4.2022****PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES  
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE  
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,  
QË PREKEN NGA PROJEKTI  
“NDËRTIM KOPSHTI DHE ÇERDHE E  
INTEGRUAR NR. 42”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim kopshti dhe çerdhe e integruar nr. 42”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 66 620 761.20 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e njëzet mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë njëzet) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 66 620 761.20 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e njëzet mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë njëzet) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Tiranë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi paraqesin dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe bën regjistrimin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Tiranë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimi i kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR****Edi Rama**



LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË SHPRONËSOHEN PËR  
INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “NDËRTIM KOPSHTI DHE ÇERDHE E INTEGRUAR NR. 42”

| Nr. | Pronari      |           |                          | Të dhëna hipotekore |                 |                |                  |                   |             |               |        |      | Vlerësimet për shpronësim |                 |               |                 |                 |              |                     | Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë) |
|-----|--------------|-----------|--------------------------|---------------------|-----------------|----------------|------------------|-------------------|-------------|---------------|--------|------|---------------------------|-----------------|---------------|-----------------|-----------------|--------------|---------------------|---------------------------------------------------|
|     |              |           |                          |                     |                 |                |                  |                   |             |               |        |      | Truall                    |                 |               | Ndërtesë        |                 |              | Vlera totale (lekë) |                                                   |
|     | Emri         | Atësia    | Mbiemri                  | Fshati ose qyteti   | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sipërfaqja totale | Truall (m²) | Ndërtesë (m²) | Volumi | Faqe | Sipërfaqja (m²)           | Çmimi (lekë/m²) | Vlera (lekë)  | Sipërfaqja (m²) | Çmimi (lekë/m²) | Vlera (lekë) |                     |                                                   |
| 1   | Jorgo Petraq | Gaqo Gaqo | Papadhopuli Papadhopulli | Tiranë              | 8270            | 2/899          | Truall           | 657.5             | 657.5       | -             | 93     | 107  | 657.5                     | 66969           | 44,032,117.50 | -               | -               | -            | 44,032,117.50       |                                                   |
| 2   | David Mark   | Bashkim - | Haxhi Shantoja           | Tiranë              | 8270            | 2/427          | Truall           | 337.3             | 337.3       | -             | 24     | 157  | 337.3                     | 66969           | 22,588,643.70 | -               | -               | -            | 22,588,643.70       |                                                   |
|     | Total        |           |                          |                     |                 |                |                  |                   |             |               |        |      | 994.8                     |                 |               | 0               |                 |              | 66,620,761.20       |                                                   |

Për tokën truall, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.



## VENDIM

Nr. 245, datë 20.4.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA  
NË VENDIMIN NR. 101, DATË 9.2.2022,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË  
TË SEKTORËVE QË DO TË  
MBËSHTETEN DHE TË MASËS  
SË FINANCIMIT NGA FONDI I  
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË E  
ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2022”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve, 6, pika 3, e 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Në vendimin nr. 101, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2.2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në shkronjën “ç”, shifra “7 250 000 (shtatë milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë” zëvendësohet me “13 500 000 (trembëdhjetë milionë e pesëqind mijë) lekë”;

b) nëndarjet “i”, “ii”, “iii”, të shkronjës “ç”, zëvendësohen me nëndarjet e mëposhtme:

i. blerjen dhe instalimin e motorit kryesor, por jo më shumë se 7 000 000 (shtatë milionë) lekë;

ii. blerjen e pjesëve të këmbimit për motor, si kollodok, biella, bronxina, këmbisha, fasho, piston, testato dhe set guarnicionesh, por jo më shumë se 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë;

iii. blerjen dhe instalimin e motorit ndihmës (gjeneratori detar), por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë;

iv. blerjen dhe instalimin e vinçit të anijes, por jo më shumë se 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë. Vinçi përfshin edhe agregatet, hidromotorin, pompë vaji friksion, multiplikator dhe tubacionet;

v. dokimi periodik i anijes, por jo më shumë se 3 000 000 (tre milionë) lekë. Dokimi periodik,

sipas kushteve të klasit, përfshin ngritjen dhe uljen nga kantieri, pastrimin dhe heqjen e bojës së vjetër, blerje boje, stuko, protektor (zinqe), riparim aksi helike;

vi. riparim i përgjithshëm i anijes, por jo më shumë se 9 000 000 (nëntë milionë) lekë. Në riparimin e përgjithshëm, përveç zërave të përcaktuar në dokimin periodik sipas nëndarjes “v”, përfshihen dhe zëvendësim llamarine, ndërrim dërrase dhe impianti elektrik.”

2. Fjalja e parë, e shkronjës “a”, të pikës 2.3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Mbështetje për ndërtimin e tregjeve të produkteve bujqësore dhe/ose tregjeve të kafshëve të gjalla për shoqëritë tregtare me kapital 100% shtetëror, të zotëruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në vlerën jo më shumë se 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë për subjekt, nëpërmjet transferimit të fondit nga llogaria ekonomike 606 në llogarinë ekonomike 604 “Të tjera transfertat të brendshme”.

3. Në nënpikën 2.5.1, shifra “950 000 000 (nëntëqind e pesëdhjetë milionë) lekë” zëvendësohet me shifrën “1 450 000 000 (një miliard e katërqind e pesëdhjetë milionë) lekë”.

4. Nënpika 2.5.11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.5.11 Procedura e prokurimit për blerjen dhe shpërndarjen e naftës për përdorim nga fermerët realizohet në përputhje me legjislacionin në fushën e prokurimit publik”.

5. Pas nënpikës 2.5.12 shtohet pika 2.5.13, me këtë përmbajtje:

“2.5.13 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kryen procedura prokurimi publik gjatë vitit 2022, sipas fondeve shtesë për mbështetjen me naftë për bujqësinë, në përputhje me legjislacionin në fushën e prokurimit publik”.

6. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Efektet financiare shtesë prej 500 000 000 (pesëqind milionë) lekësh, për mbështetjen me naftë, do të përballohen nga paketa e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

**VENDIM****Nr. 246, datë 20.4.2022****PËR MIRATIMIN E PAKETËS SË  
PROGRAMIT KOMBËTAR PËR  
KUJDESIN E SHIKIMIT PËR FËMIJËT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e paketës së Programit Kombëtar për Kujdesin e Shikimit për Fëmijët si një paketë shërbimesh ndihmëse në shëndetin publik, me qëllim identifikimin e hershëm të dëmtimeve të shikimit dhe parandalimin e problematikave të shikimit e dëmtimeve të tjera të shikimit.

2. Objektivat e paketës së Programit Kombëtar për Kujdesin e Shikimit për Fëmijët do të arrihen me ndjekjen e këtyre hapave:

a) Programi Kombëtar i Depistimit në etapat, si më poshtë vijon:

i. te të porsalindurit;

ii. në 6-mujorin e dytë të vitit të parë të jetës deri në 3 vitet e para të jetës;

iii. depistim periodik në moshat nga 4–14 vjeç;

b) vlerësimi okulistik/optometrik bazuar në protokollet e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

c) përgatitja e një regjistri kombëtar për problemet e shikimit të fëmijëve.

3. Depistimi te të porsalindurit kryhet nga neonatologët, në maternitetet publike ose jopublike, sipas protokolleve të përcaktuara. Nëse konstatohen probleme, njoftohet prindi dhe rekomandohet për ekzaminim të specializuar.

4. Depistimi në 6-mujorin e dytë të lindjes kryhet nga mjekët pediatër/të familjes në konsultorin e fëmijës, në qendrat e konsultorit në të gjithë vendin. Fëmijët që shfaqin probleme rekomandohen nga mjeku i familjes për ekzaminim të specializuar.

5. Depistimi deri në moshën 4 (katër) vjeç kryhet nga mjekët e familjes në qendrat shëndetësore dhe nga mjekët e konsultorit të fëmijës. Paraqitja e fëmijës në konsultor për

vaksinat, sipas kalendarit të vaksinimit, shoqërohet edhe me depistimin për shikimin. Depistimi dokumentohet në regjistrë.

6. Fëmijët që rezultojnë me problematika gjatë depistimit rekomandohen nga mjeku i familjes për ekzaminim të specializuar.

7. Përpara regjistrimit në klasë të parë, për fëmijën duhet të kryhet depistimi nëpërmjet vizitës okulistike/optometrike.

8. Për moshën 6 (gjashtë) deri në 14 (katërmëdhjetë) vjeç, depistimi, sipas udhëzimeve, kryhet në shkollë nga mjekët e shkollave dhe, në mungesë të personelit shëndetësor në shkolla, depistimi kryhet nga mjekët e familjes, sipas zonave përkatëse që mbulon qendra shëndetësore.

9. Gjatë depistimit, personeli shëndetësor dokumenton rezultatet e depistimit në një regjistrë të veçantë me të dhënat bazë të nxënësit.

10. Fëmijët, që rezultojnë me probleme gjatë depistimit, rekomandohen nga personeli shëndetësor/mjeku i familjes për vizitë të specializuar.

11. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të hartojë planin e shtrirjes së programit, sipas etapave të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi.

12. Organizimi i programit të depistimit të shikimit për fëmijët ndiqet e monitorohet nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

13. Të dhënat për çdo përfitues të këtij programi analizohen nga Instituti i Shëndetit Publik pas raportimit nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

14. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik dhe spitalet gjinekologjike e obstetrike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**



## VENDIM

Nr. 248, datë 20.4.202

**PËR NJË SHITESË FONDI NË  
BUXHETIN E VITIT 2022, MIRATUAR  
PËR MINISTRINË E TURIZMIT DHE  
MJEDISIT NGA FONDI REZERVË I  
BUXHETIT TË SHITETIT PËR VITIN  
2022, PËR PAGESËN E STUDIOS, PËR  
ÇËSHITJEN E ANULIMIT TË  
VENDIMIT TË ARBITRAZHIT ICSID  
CASE NO. ARB/14/26**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, në zërin “Shpenzime korente”, të programit buxhetor 01110 “Planifikim, menaxhim, administrim”, i shtohet fondi prej 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh, për kryerjen e pagesës për detyrimet që rrjedhin ndaj studios “Gomling” WLG, për procesin e anulimit të vendimit të arbitrazhit ndërkombëtar, datë 20.3.2020, ICSID Case no.ARB/14/26, ndërmjet shoqërisë “Albaniabeg Ambient” sh.p.k. dhe të tjerë kundër Republikës së Shqipërisë.

2. Efekti financiar prej 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR  
Edi Rama**

## URDHËR

Nr. 174, datë 15.4.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR  
VAKSINAT QË PËRDOREN KUNDËR  
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT, NË  
PROGRAMET RUTINË TË  
VAKSINIMEVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; pika 8, e nenit 102, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

## URDHËROJ:

1. Miratimin e kriterëve për përdorimin e vaksinave kundër sëmundjes së pseudopestit në programet e vaksinimit rutinë, sipas shtojcës I, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË  
DHE ZHVILLIMIT RURAL  
Frida Krifca**

## SHTOJCA I

1 Në programet e vaksinimit rutinë, vaksinat që përdoren kundër sëmundjes së pseudopestit duhet të jenë të dobësuar dhe të përgatitura nga një shtam i virusit të sëmundjes së pseudopestit, ndaj të cilit është testuar dhe ka treguar se ka një indeks patogjeniteti intracerebral (ICPI):

a) më pak se 0.4, nëse administrohen jo më pak se 107 EID50 për secilin shpendë, në testin ICPI; ose

b) më pak se 0.5, nëse administrohen jo më pak se 108 EID50 për secilin shpendë, në testin ICPI.

**NJOFTIM****Nr. 5257, datë 20.4.2022****MBI HYRJEN NË FUQI TË  
MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE**

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Serbisë, për njohjen reciproke të operatorëve ekonomikë të autorizuar-autorizimet për sigurinë dhe mbrojtjen (OEAS), ka hyrë në fuqi më 7 prill 2022.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I  
MINISTRISË PËR EVROPËN  
DHE PUNËT E JASHTME  
Armand Skapi**

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë